

Standardi i ri [ISO 15743:2008](#) do të na ndihmojë të menaxhojmë rrezikun në vendet e punës me temperaturë të ulët.

Dhjetor 2008



Një standard i ri ISO siguron një metodologji të plotë për vlerësimin e rrezikut dhe menaxhimin e punës në mjediset e ftohta.

Për shkak të ndikimit negativ të mjedisve ftohta në shëndetin e njeriut dhe në produktivitetin e tij, cilësinë dhe sigurinë në punë, nevojitet një strategji e plotë për vlerësimin e rrezikut dhe menaxhimin e praktikave dhe metodave për kryerjen e punës në mjediset me klimë të ftohtë.

Standardi S SH ISO 15743:2008, **Ergonomia e ambienteve termale** - Mjediset e ftohta të punës - **Vlerësimi i rrezikut dhe menaxhimi**, është hartuar për të përshkruar metodat dhe praktikatat për vlerësimin dhe menaxhimin e shëndetit profesional si dhe rrezikun e performancës në mjediset e ftohta të punës.

Standardi jep udhëzime praktike për analizën e rrezikut dhe menaxhimin në kushte pune të ftohta. Ai përshkruan:

- modelin dhe metodat për praktikatat e vlerësimit të rrezikut në ambientet e ftohta të punës;
- modelin dhe metodën për kujdesin ndaj sëmundjeve profesionale dhe identifikimin e punonjësve që kanë simptoma të rritjes së ndjeshmërisë ndaj të ftohtit përfshi dhe udhëzimet optimale dhe instruksionet individuale për mbrojtjen ndaj të ftohtit.
- manualin informativ për mënyrën e aplikimit të standardeve të ndryshme termike ndërkombëtare dhe metoda të tjera shkencore të cilat vlerësojnë rreziqet që lidhen me të ftohtit
- modelin dhe metodat për praktikatat e menaxhimit për rrezikun nga të ftohtit
- shembuj praktike të punës në kushte pune të ftohta

Të punuarit në një mjedis të ftohtë mund të krijojë disa lloj efektsh të kundërta në mbarëvajtjen dhe shëndetin e njerëzve: mosrehati termike, sforsim të tepërt, rënie të produktivitetit dhe shtim të sëmundjeve dhe plagosjeve që shkaktohen nga të ftohtit.

Të ftohtit mund të bashkëveprojë edhe me faktorë të tjerë në vendin e



punës, duke sjelle modifikimin ose rritjen e rrezikut, nga një rrezik i zakonshëm në një rrezik më të madh që shoqërohet me plagosje që vijnë si rezultat i të ftohtit ose temperaturave të ulëta.

Një numër industrish janë shumë të ekspozuara ndaj të ftohtit, si p.sh:

- mjedisi i jashtëm (të tilla si industria e ndërtimit, mirëmbajtja e linjave elektrike, linjat e gazit, sistemet e telekomunikacionit ose rrugët, industria e agrikulturës dhe pyjeve, industria e peshkimit);
- mjedisi i brendshëm (industria e prodhimit të mishit, depot frigoriferike në industri dhe në zinxhirin e transportit nga industria (prodhimi) deri tek dyqanet).

Standardi mbulon punën që kryhet brenda mjeteve të transportit, puna në ambiente të brendshme dhe në det të hapur, dhe nuk është i zbatueshëm gjatë zhytjes ose llojeve të tjera të punëve që zhvillohen nën ujë.

Standardi S SH ISO 15743:2008 plotëson një seri standardesh të ISO që kanë lidhje me punën në kushtet e të ftohtit, si dhe në fusha të tjera të stresit termik. Ai krijon një bazë të mirë për praktikën e sigurisë dhe shëndetit në punë dhe ndihmon sipërmarrësit, prodhuesit, drejtuesit, personelin e sigurisë në punë, punonjësit e kujdesit shëndetësor në punë dhe të tjerët” komenton Prof. Ken Parsons, kryetar i nën komitetit që ka hartuar këtë standard ISO”.

S SH ISO 15743:2008, *Ergonomia e ambienteve termale- Vendet e ftohta të punës- Vlerësimi i rrezikut dhe menaxhimi*, u hartua nga Komiteti Teknik (KT) i ISO, ISO\TC 159, Ergonomia, nënkomiteti SC 5, *Ergonomia e mjedisit fizik*.

S SH ISO 15743:2008 — ***Ergonomia e ambienteve termale - Vendet e ftohta të punës - Vlerësimi i rrezikut dhe menaxhimi*** është adoptuar si Standard Shqiptar (S SH), duke qënë identik me origjinalin, nga Komiteti Teknik i DPS, kushton **4165** lekë për jobashkëpunëtorë dhe **2082** lekë për bashkëpunëtorë dhe mund ta gjeni në zyrat e DPS-së në adresën:

Rruga: "Mine Peza", Nr. 143/3,

1014 -Tiranë, Shqipëri.

Kutia Postare 98

Tel: + 355 (04) 222 62 55

Fax: + 355 (04) 224 71 77

E-mail: info@dps.gov.al

Web: www.dps.gov.al

Thënie dhe fakte

“Vlera e standardit qëndron në faktin se lejon zgjidhjet dhe produktet që mbështeten gjatë gjithë jetëgjatësisë së tyre në tërësinë e industrisë, dhe janë të arritshme nga shumë shitës të ndryshëm. Sa më e gjerë të jetë fusha që përfshin industria, aq më tepër vlera ka për përdoruesin”.

Standard do te thotë optimizmi

Krizat e energjisë ngacmojnë një kërkim për optimizmi, i cili përkthehet në mbështetje për standardet. Për shembull, në Francë kriza e vajit në 1970 i dha shtysë prodhimit të një serie prej 58 centralesh elektrik të standardizuar.

Kohet e fundit në Shtetet e Bashkuara (Dhjetor 2007), qeveria kaloi në Aktin e Sigurisë së Pavarësisë së Energjisë (Energy Independence and Security Act). Kjo i bën rezervat specifike për hartimin e standardeve të ndërveprueshme për infrastrukturën elektrike. Hartimi dhe përdorimi i standardeve si fillim nënkupton mundimin dhe kostot dhe më pas me kalimin e kohës arrihen përfitimet pas një kohe të gjatë.